



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTLIGJI

Nr. _____, Datë _____

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 114, DATË 22.10.2015 “PËR AUDITIMIN E
BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave;

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në Ligjin nr.114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4, pikat 7 dhe 13, ndryshohen si më poshtë:

7. “Auditues i brendshëm” është profesionisti, i cili është i certifikuar, regjistruar si i tillë dhe ka ndjekur trajnimin e vijueshëm profesional sipas kërkesave të këtij ligji.
13. “Kodi i Etikës për audituesit e brendshëm” është një akt administrativ që miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, në të cilin janë të përcaktuara qartë rregullat e sjelljes dhe parimet që duhet të udhëheqin punën e audituesve të brendshëm në sektorin publik.

Neni 2

1. Në nenin 10, pika 1, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:
 1. Të gjitha njësitë publike sipas kuptimit të këtij ligji, duhet të sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm sipas njërës prej formave të përcaktuara në vijim:
 - a) Kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm nga njësi e auditimit të brendshëm ku kjo njësi është e përfshirë në strukturën organizative të njësisë publike;
2. Pas shkronjës “c”, shtohen shkronja “ç” dhe “d” me këtë përmbajtje:
 - ç) Ministri përgjegjës për financat përcakton rregullat për marrëveshjet dhe kontraktimet e parashikuara në shkronjat “b” dhe “c” të këtij neni.
 - d) Në rastet kur njësitë publike përmbushin kriteret për krijimin e një njësie të auditimit të brendshëm, por nuk mund të përmbushin kriteret për punësimin e audituesve të brendshëm sipas përcaktimeve në nenin 13 të këtij ligji, ministri përgjegjës për financat përcakton organizimin e funksionit të brendshëm në këto njësi publike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

1. Në nenin 11, pika 2, shkronjat “b”, “c” dhe “d”, ndryshohen si më poshtë:
 - b) Drejtuesi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm duhet të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion dhe/ose të jetë i certifikuar si Auditues i Brendshëm;
 - c) Audituesi i Brendshëm duhet të ketë përvojë pune 3 vjet në profesion dhe/ose të jetë i certifikuar si Auditues i Brendshëm.
 - d) Punonjësi që punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe që nuk zotëron certifikatën si Auditues i Brendshëm, gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë. Brenda kësaj periudhe ky punonjës duhet t'i nënshtrohet detyrimisht procedurës së certifikimit si Auditues i Brendshëm. Në rast se brenda këtij afati punonjësi nuk certifikohet si Auditues i Brendshëm, atëherë këtij punonjësi i ndërpriten marrëdhëniet e punës, të cilat konsiderohen që janë ndërprerë për shkak të ligjit.
2. Pas pikës 3 shtohen pikat 4, 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:
 4. Drejtuesit e Njësive të Auditimit të Brendshëm emërohen dhe shkarkohen me pëlqimin me shkrim nga ministri përgjegjës për financat. Kërkesa për emërim dhe shkarkim të drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm, shoqërohet me arsye dhe kopje të dokumenteve përkatëse.
 5. Numri i audituesve të brendshëm që përmbushin kërkesën e "studimit në disiplina të tjera", të përcaktuar në shkronjën “a” të këtij neni, nuk do të jetë më shumë se një e treta e numrit të përgjithshëm të audituesve të brendshëm të Njesisë së Auditimit të Brendshëm. përkatëse.
 6. Paga e punonjësve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm dhe të njësive të auditimit të brendshëm përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat (.trajtohen në mënyrë të veçantë) dhe duhet të jenë të harmonizuara me pagat e audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Neni 4

1. Në nenin 12, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:
 - a) Vendimmarrjen e krijimit të Komitetit të Auditimit në njësinë publike përkatëse sipas kritereve të përcaktuara nga ministri përgjegjës për financat;
2. Pas shkronjës “e ” shtohet neni 12/1 me përmbajtje si më poshtë:

Neni 12/1

Procedura për raportimin e parregullsive

1. Titullari i njësisë publike krijon sistemin për parandalimin e rrezikut për parregullsi dhe mashtrim dhe ndërmerr veprime kundër parregullsive dhe mashtrimeve.
2. Çdo punonjës, përfshirë edhe audituesit e brendshëm, informon për çdo parregullsi ose mashtrim të mundshëm titullarin e njësisë publike dhe nëse e konsideron të dobishme, organet kompetente.
3. Pas pranimit të raportit për konstatimin e parregullsive, mashtrimeve dhe korrupsionit, titullari i njësisë publike, ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe informon organet kompetente.

4. Personi raportues dhe audituesi i brendshëm nuk duhet të çenohet, si rezultat i komunikimit të informacionit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, me kusht që të kenë vepruar në mënyrë të arsyeshme dhe me ndershmëri.

Neni 5

1. Në nenin 13, fjala “Komitet i Auditimit të Brendshëm” zëvendësohet me fjalën “Komiteti i Auditimit”.
2. Në pikën 1, shkronja “b” dhe “d” ndryshohen si më poshtë:
 - b) vlerësuar dhe dhënë mendime mbi planin strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm;
 - c) monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit;
3. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:
 2. Komiteti i Auditimit krijohet dhe funksionon në njësitë publike në bazë të kritereve të vendosura me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 6

Në nenin 14, shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:

Neni 14/1

Raportimi mbi mashtrimin dhe korrupsionin

1. Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm dhe audituesit e brendshëm duhet të kenë njohuritë e duhura dhe të mjaftueshme për të identifikuar treguesit e mashtrimit dhe/ose praninë e çfarëdo situatash që mund të mundësojnë mashtrime.
2. Kur identifikohen treguesit e mashtrimit dhe/ose të korrupsionit, audituesit e brendshëm kanë detyrimin për të ndaluar procedurën e auditimit dhe për të informuar menjëherë drejtuesin e njësisë së auditimit të brendshëm, i cili nga ana e tij do të informojë menjëherë titullarin e njësisë së audituar.
3. Në rast se titullari i njësisë së audituar nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme pas informacionit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, drejtuesi i auditimit të brendshëm do të informojë Komitetin e Auditimit dhe strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në ministrinë përgjegjëse për financat.

Neni 7

Në nenin 19, pika 2 dhe pika 3 ndryshohen si më poshtë:

1. Të drejtën për të aplikuar në procesin e certifikimit e kanë individët e klasifikuar në shkronjën “ç”, të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji si dhe punonjës të tjerë të punësuar në njësitë publike që kryejnë funksione që kanë lidhje me auditimin, pas kërkesës me shkrim dhe të argumentuar nga Titullari i njësisë publike.

2. Certifikata “Auditues i Brendshëm në sektorin publik” dhe çdo certifikatë tjetër për qëllime të këtij ligji lëshohet nga ministri përgjegjës për financat.

Neni 8

Në nenin 20, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

2. Të gjithë audituesit , të përcaktuar në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji, kanë të drejtën e trajnimit të vijueshëm profesional dhe të gjithë audituesit e brendshëm të certifikuar duhet të ndjekin të paktën 80 orë trajnimi në dy vjet.

Neni 9

Në nenin 21, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

1. Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm është organ këshillimor për ministrin përgjegjës për financat dhe mbështet strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, lidhur me procesin e certifikimit dhe trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm.

Neni 10

1. Në nenin 22, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

4. Titullari i njësisë publike i propozon ministrit përgjegjës për financat rastet e çregjistrimit të audituesit të brendshëm nga Regjistri Kombëtar, kur nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, verifikohen rastet e parashikuara nga pika 1, shkronjat “b” dhe “c të këtij neni.

2. Pas pikës 4, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

5. Forma dhe përmbajtja e Rregjistrimit Kombëtar të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik përcaktohet nga ministri përgjegjës për financat me propozim të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm

Neni 11

1. Në nenin 23, pika 2, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

- c) Miratimin e politikave, manualeve, procedurave, udhëzimeve dhe rregulloreve të auditimit të brendshëm, për përshtatjen dhe përafrimin e tyre me standardet ndërkombëtare të pranuar të auditimit të brendshëm, me propozim të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm;

2. Pas shkronjës “d” shtohen shkronjat : “e”, “f” dhe “g” me këtë përmbajtje:

- e) Për funksionimin e duhur të auditimit të brendshëm në njësitë publike, në ato raste kur konstaton se shërbimi i auditimit të brendshëm nuk kryhet, ose kryhet jo në përputhje të kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi, Ministri mund të kërkojë organizimin e angazhime të auditimit të

brendshëm për sistemin apo fusha specifike të menaxhimit të financave publike, nëpërmjet grupeve të përbashkëta të auditimit.

- f) Mosrespektimi nga titullari i njësisë publike të kërkesave të nenit 12 dhe 12/1 përbën rast të rëndë të mosfunksionimit të auditimit të brendshëm në njësinë publike. Në këtë rast ministri përgjegjës për financat rezervon të drejtën e bllokimit të përkohshëm të përdorimit të fondeve buxhetore, të përcaktuara në aktin vjetor të Buxhetit të Shtetit, për vitin përkatës, në nivel programi, zëri apo projekti, deri në plotësimin e kërkesave ligjore.
- g) Në rast të mosrespektimit nga drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm, të përgjegjësive të parashikuara në nenin 14 të këtij ligji, ministri përgjegjës për financat, mund t'i propozojë Titullarit të njësisë publike, fillimin e procedurave disiplinore .

Neni 12

1. Në nenin 24, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

- a) Zbaton Strategjinë e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në fushën e auditimit të brendshëm publik si dhe e monitoron këtë veprimtari në nivel kombëtar;

2. Shkronja “e” shfuqizohet.

3. Pas shkronjës “ë” shtohen shkronjat “f” dhe “g”:

- f) Kryen auditime të brendshme me urdhër të ministrit përgjegjës për financat në rastet e shkronjës “e” të nenit 23 të këtij ligji.
- g) mban marrëdhënie profesionale me organizatat ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe me struktura homologe, përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.

Neni 13

- 1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë ndryshimet aktet nënligjore, në zbatim të nenit 3,5 dhe 9.
- 2. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat, që brenda dymbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë ndryshimet në aktet nënligjore në zbatim të neneve 2, 7, dhe 11 të këtij ligji.

Neni 14 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R

LINDITA NIKOLLA